



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 331/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrim (PAI) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) dega në Ferizaj, për shkak të dëmtimit dhe shantazhit të anëtarëve partiak, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrim (PAI), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.10.2013, nga subjekti politik PAI dega në Ferizaj, në të cilën theksohet se Avni Kopili dhe Nusret Bojani kanë dëmtuar subjektin politik PAI me ç'rast të dy kandidatët në fjalë janë kërcënuar dhe janë korrumpuar me qëllim të dëmtimit të PAI-t. Sipas parashtruesit të ankesës personat e lartpërmendur janë regjistruar si kandidat në listën e PAI-së për çka edhe dëshmon formulari i plotësuar dhe i nënshkruar për certifikimin e kandidateve, mëtej në ankesë theksohet se nga presioni dhe dhuna psikike këta dy detyrohen që të aderojnë medialisht në rradhët e PDAK-së. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se këta dy persona në bazë të Rregullave Zgjedhore nuk kanë të drejtë të jenë pjesë e një subjekti tjetër politik dhe me këtë rast kërkojnë që veprimet e tyre të sanksionohen.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDAK në të cilën thekson se aderimi i Avni Kopilit dhe Nusret Bojanit ka qenë vullnetar dhe se për këtë çështje propozon që personat në fjalë të kontaktohen personalisht rreth aderimit të tyre në këtë subjekt politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet e ankimore se anëtarët e subjekti politik PAI janë të kërcënuar dhe të shantazhuar dhe se aderimi i tyre në një subjekt tjetër politik ka

dëmtuar subjektin politik PAI nuk qëndrojnë ngase pretendimet e theksuara në ankesë nuk janë mbështetura më asnjë provë nga pala ankuese që do te ndikonte në marrjen e vendimit. PZAP-i pretendimet e tilla i vlerësoi si të pabazuara dhe te pa argumentuara, andaj në kuptim te nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

Anr. 331/2013 më datën 25.10.2013



**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-*.